



Planuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivery	27-05-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTHCL	3133/2022		116



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.309/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.309/2022 të datës 29.03.2022 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat me adresë kundër Vendimit

Nr.2/2022, me Nr. Prot:05 të datës 28.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 26.05.2022, mori këtë:

### V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.309/2022 të datës 29.03.2022 të parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.2/2022 me Nr. Prot:05 i datës 28.02.2022 i Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës.

### A r s y e t i m

Divizioni i Standardeve Profesionale pranë Administratës Tatimore të Kosovës, ka përgatitur raportin mbi trajtimin e rastit të ankuesit respektivisht lirimin nga barra tatimore e tatimpaguesit konkretisht lirimin e automjetit Lamborgini me date 04.10.2021 me kërkesë të vazhdueshme të tatimpaguesit, pa miratimin e udhëheqësit të

drejtpërdrejtë dhe në kundërshtim me Ligjin për Administratën Tatimore të Kosovës, andaj bazuar në këtë raport, ndaj ankuesit iu punësuar sipas Akt Emërimit të datës 22.10.2013 në pozitën "Inspektor i Lojërave të Fatit", në Administratën Tatimore të Kosovës, dhe në bazë të Vendimit të datës 27.07.2020 është caktuar zëvendësues i Udhëheqësit të Ekipit 2 në Divizionin për Menaxhimin e Masave të Sforcuara në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës, Zyrtarja e Lartë për Hetime në Divizionin për Standarde Profesionale më datë 10.02.2022 ka kërkuar nga Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës që të dërgohet rasti në komision disiplinor. Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore më datë 02.02.2022 ka proceduar rastin e ankuesit tek Kryetari i Komisionit Disiplinor.

Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës, më datë 28.02.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 2/2022 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *"Ndalim i ngritjes në detyrë dhe rritje në shkallën e pagës për një periudhë 2 vjeçare, përfshirë edhe rikthimin në pozitën paraprake që ka me akt emërim ose në një pozitë ekuivalente"*.

Ankuesi, kundër Vendimit Nr.2/2022, me Nr. Prot:05 të datës 28.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës, përmes përfaqësuesit të tij fizikisht më datë 29.03.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:1668/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet për shkak të shkeljeve të ligjit material dhe shkeljeve procedurale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.04.2024 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Administrata Tatimore e Kosovës. Këshilli më datë 13.04.2024 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Për shkak të kompleksitetit të lëndës, më datë 13.05.2022 Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerr Vendim VK.nr.45/2022 më të cilin ka bërë zgjatjen e afatit për vendosje për ankesën e ankuesit për dhjetë ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 20.10.2021 e regjistruar me Nr. Prot:1668/2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 24.03.2022; Akt Emërimit me Nr. Prot:02/190/09 të datës 22.01.2013 në emër të ankuesit; Vendimin me Nr. Proti:250 të datës 27.07.2020 për caktimin e ankuesit zëvendësues i Udhëheqësit të Ekipit 2 në Divizionin për Menaxhimin e Masave të Sforcuara; Kërkesë për dërgimi e rastit për komisionin disiplinor në ATK e datës 01.02.2022; Shkresë përcjellëse për KD e datës 02.02.2022; Vendimin Nr.2/2022, me Nr. Prot:05 të datës 28.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore

të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 04.04.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 13.04.2022; Vendimi me Nr.Prot: 58 i datës 31.01.2020 për caktimin e ankuesit si ushtrues të detyrës Udhëheqësit të Ekipi 2 në Divizionin për Menaxhimin e Masave të Sforcuara; Procesverbali e seancës dëgjimore të Komisioni Disiplinore i datës 28.02.2022; Raportin mbi rastin Nr. 25/21 -“ lirim i barrës tatimore nga Zyrtarja e Lartë për Hetime në Divizionin për Standarde Profesionale për Komisionin Disiplinor i datës 01.02.2022; Vendimin me Nr. Prot:211 i datës 27.07.2021 për caktimin e zëvendësuese Udhëheqës i Divizionit për Masat e Sforcuara; Akt Emërimit e datës 08.11.2019 për pozitë Udhëheqës Ekipi i MD; Emailin e datës 04.11.2021 nga për Emailin e datës 03.11.2021 nga Emailin e datës 03.11.2021 nga Emailin e datës 28.10.2021 dhe 20.10.2021 nga Lista e automjeteve që i posedon tatimpaguesi; Emaili i datës 19.10.2021 nga Emailin e datës 18.10.2021 nga Emailin e datës 18.10.2021 nga ankuesi; Emailin e datës 18.10.2021, 15.10.2021 nga Emailin e datës 15.10.2021 nga për Emailin e datës 15.10.2021 nga Emailin e datës 15.10.2021 nga për Faturë nga Banka Ekonomike e datës 08.06.2021; Dokumentin Unik Doganor; Fatura nga Raiffeisen Leasing e lëshuar më datë 29.01.2021; Dokumentin Unik Doganor i datës 13.10.2021; Urdhërpagesë nga Dogana e Kosovës e datës 14.10.2021; Faturë nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës data e faturimit 14.10.2021; Shkresë me titull mandati elektronik nga Banka Kombëtare Tregtare e datës 14.10.2021; Faturë nga e datës 14.10.2021; Listë e datës 16.09.2021; Dekalratën e datës 08.11.2021 me Nr.25/21; Emailin e datës 12.11.2021 nga Emailin e datës 09.11.2021 nga Emailin e datës 17.11.2021 nga Kërkesë për marrëveshje pagesë më këste e datës 02.11.2020; Marrëveshjen për pagesë e datës 03.11.2020; Marrëveshjes për pagesë-lista e vlerësimeve; Listën për pagesa e kësteve të marrëveshjes e datës 17.11.2021; Konfirmim për transaksionin e datës 03.11.2020; Dëshmi për pagesë të këstit me marrëveshje e datës 03.11.2020; Pagesë e Faturës në ProCredit Bank e datës 10.08.2021; Përgjigje në kërkesë e datës 18.10.2021; Kërkesë për informata nga palët e treta e datës 19.10.2021; Faturë Nr. AGR-0036/20-T nga Raiffeien LEASING e datës 22.07.2020; Faturë nga Raiffeien LEASING e datës 22.07.2020; Faturë nga Raiffeien LEASING e datës 22.07.2020; Faturë nga Raiffeisen e datës 22.07.2020; Faturë Nr. AGR-0441/20-T nga Raiffeisen LEASING e datës 30.03.2021; Shkresë për detajet e transaksionit nga NLB Banka e datës 14.10.2021; Fature për shërbimet e ANP-së gjatë importit nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës; Shkresë me titull Barra Tatimore Nr. 11-430/05-0231554/21; Certifikatën nga Agjencia Kadastrale e Kosovës e datës 19.06.2015; Emailin e datës 18.02.2021 nga ; Emailin e datës 09.02.2021 dhe 23.12.2020 ng ; Emailin e datës 19.04.2021 nga Emailin e datës 16.04.2021 nga Emailin e datës 24.12.2020 nga Raportin e detajuar për aktivitet e mbledhjes e datës 05.05.2021; Emailin e datës 22.11.2021 nga Standardet Profesionale; Emailin e datës 22.11.2021 nga Shkresë me titull Arsyeja e Lirimit të barrës tatimore në automjet ‘ë subjektit i datës 22.11.2021; Emailin e datës 23.11.2021 nga Kontratë për shitblerjen e automjetit LRP.nr.12754/2021, Ref Nr.2207/2021; Dëshmi me titull Analitike e Furnitor për periudhën 01.01.2021-23.11.2021; Emailin e datës 11.01.2022 nga S.Syla; Emailin e datës 01.02.2021 nga F.Avdiu; Raportin e Intervistës për të Përcaktuar Personin Përgjegjës datë 25.11.2021; Lista e pronarëve në emër të korporatës Raport për vizituar përmbushëse të

subjekt që kanë obligime; Pagesë e faturave me e-Banking në ProCredit Banke datë 07.12.2021; Dëshmi për Pagesë të këstit me marrëveshje e datës 03.11.2021; Emailin e datës 07.12.2021 nga Deklaratën e ankuesit e datës 12.01.2022; Emailin e datës 19.01.2022 nga Formularin për kërkesë apo ankesë e datës 19.01.2022; Shkresë me titull barra tatimore e datës 18.01.2022; Shkresë me titull shitje të pa-deklaruara e datës 16.12.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit është **pabazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar ligjshmërinë e Vendimit Nr.2/2022 me Nr. Prot:05 të datës 28.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës, ka konstatuar që Administrata Tatimore e Kosovës ka lidhur marrëveshje për pagesën e borxhit tatimor me këste në vlerën 547.610.83 Euro me subjektin SHPK, ndërsa tatimpaguesi nuk ka arritur të paguaj borxhin sepse ka mbetur borxh në vlerën 394.850.53 Euro, dhe në këtë kohë ankuesi më datë 04.10.2021 pas disa kërkesave të vazhdueshme të subjektit ka bërë lirimin e barrës tatimore

Në bazë të nenit 28 paragraf 7 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, është përcaktuar se: *“Mosrespektimi i marrëveshjes nga tatimpaguesi do të ketë pasojë rivendosjen e interesit. Në rast të kërkesës për marrëveshje vijuese për të njëjtin detyrim tatimor dispozitat e paragrafit 6. të këtij neni nuk do të aplikohen...”*, nenit 33 paragrafi 5 nën paragrafi 5.4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 15 /2010 për Zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, i cili përcakton se: *“...Marrëveshja sipas dispozitave të paragrafit 6 të Nenit 28 duhet të plotësojë kushtet vijuese: tatimpaguesi duhet të kryejë të gjitha pagesat në apo para datës së përshkruar në marrëveshje. Marrëveshja, përcakton datën në të cilën pagesa periodike duhet të bëhet”*, mbi këtë bazë subjekti nuk ka bërë respektimin e marrëveshjes së lidhur me Administratën Tatimore të Kosovës sipas legjislacionit përkatës.

Bazuar në provat e lëndës, lirimi i automjetit respektivisht lirimi i barrës tatimore është bërë pa pasur ndonjë pasuri tjetër tatimore të siguruar me barrë tatimore që do t'a mbulonte shumën e detyrimit tatimor që subjekti ka pasur në kohën e lirimit të automjetit të lartcekur, andaj me rastin e lirimit të kësaj barre ankuesi nuk ka analizuar në mënyrë të drejtë kontratën e shitblerjes së automjetit, si rrjedhojë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuar me nenin 33 paragrafi 10 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe nenin 32 paragrafi 10 i Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2010 për Zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, për lirimin e barrës tatimore për subjektin. sepse nuk ka arritur të bëjë pagesën sipas marrëveshjes, e cila marrëveshja është dashur të menaxhohet nga ekipi të cilin e ka udhëheq ankuesi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi ka bërë lirim të barrës tatimore pa miratimin e udhëheqësit të tij të drejtpërdrejtë, sepse këtë ankuesi e ka pranuar edhe në seancën e Komisionit Disiplinor, po ashtu ankuesi me rastin e lirim të kësaj barre të njëjtën nuk e ka regjistruar në VKM, sepse e njëjta është regjistruar pesëmbëdhjetë (15) ditë pas lirim të kësaj barre, kështu që ankuesi këtë veprim nuk ka mundur të arsyetoj me asnjë provë të vetme, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se veprimet e ankuesit bien ndesh me nenin 25 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përfundimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike”,* dhe nenin 28 të këtij ligji, i cili përcakton se: *“Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij”,* ndërlidhur me këtë, ankuesi me veprimet e tij, ka bërë shkelje të rënda të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi pozitën Udhëheqës i Ekipit 2 në Divizionin për Menaxhimin e Masave të Sforcuara, nuk e ka ushtruar me akt emërim të përhershëm por këtë e ka ushtruar sipas Vendimit të datës 27.07.2020 si zëvendësues, andaj edhe masa disiplinore *“Ndalim i ngritjes në detyrë dhe rritje në shkallën e pagës për një periudhë 2 vjeçare, përfshirë edhe rikthimin në pozitën paraprake që ka me akt emërim ose në një pozitë ekuivalente”,* është masë e drejtë në raport me shkeljen nga ana e ankuesit, dhe në asnjë formë Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës, ankuesit nuk i ka shqiptuar dy masa disiplinore për një shkelje.

Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.2/2022 me Nr. Prot:05 të datës 28.02.2022, ka arritur të konstatoj saktë dëmin e shkaktuar nga ankuesi me veprimet e tij, si rrjedhojë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se janë plotësuar elementet e përgjegjësisë disiplinore të parapara me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, përveç të lartcekurave ka konstatuar që Vendimi Nr.2/2022 me Nr. Prot:05 i datës 28.02.2022 i Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës, është në pajtim me nenin 48 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave”,* kështu që Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në të

lartcekurat, konstaton se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit, është në pajtim me legjislacionin për zyrtarët publikë, respektivisht Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës me rastin e shqiptimit të kësaj mase disiplinore, ka vepruar në pajtim me nenin 45, nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3, nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, nenin 48 paragrafi 3 dhe 4, nenin 50 paragrafi 1, 2, 3 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe dispozitave të nenit 8 paragrafi 3, nenit 11, nenit 12, nenit 13 paragrafi 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, andaj pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.


Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.309/2022

**Avdyl BEKTESHI**  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Malsore Gashi-BAJRAKTARI**  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

